



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 299/2019

Datë: 10 maj 2019

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 10 maj 2019-KPK/Nr. 298/2019, shpall:

**SHPALLJE E BRENDSHME**

- I. Për plotësim me një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.
- II. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:
  1. Të kenë mandat të përhershëm;
  2. Të kenë vlerësim pozitiv të performancës;
  3. Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit;
  4. Pjesëmarrja në trajnime që ndërlidhet me procedurën penale për të mitur, mjetet juridike, praktikat juridike të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare do të merret parasysh.
- III. Kandidati që parashtron kërkesë duhet të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:
  1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
  2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
  3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektiviisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar,

publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.

V. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 13 maj 2019 deri më datë 28 maj 2019.

VI. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e katërt (4) të ish ndërtesës së EULEX-it, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 413, të mbyllura në zarf, ose me postë.